



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR

SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, STATISTIKAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME
PUBLIKUN, MEDIAN DHE ME JASHTË

Tiranë, më datë 27.07.2026

KOMUNIKIM PËR MEDIAN

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues monokratik të përbërë nga gjyqtari Engert Pëllumbi, sot më datë 27.07.2026, **disponoi për çështjen penale nr. 177 akti, datë 12.06.2026 regjistrimi**, mbi ankimin e ankuesit E.A (T.): “Ankim kundër vendimit nr. 89, datë 29.05.2026 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt: Realizimin e seancës gjyqësore për informimin mbi gjendjen e procedimit dhe verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit të dhënë ndaj shtetasit E.A. Zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 të Kodit të Procedurës Penale, me një masë tjetër më të butë”, si vijon:

Ndryshimin e vendimit nr. 89, datë 29.05.2026 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në këtë mënyrë:

- Pranimin e kërkesës;
- Zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, e caktuar me vendimin nr. 52, datë 02.06.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale;
- Urdhërohet personi nën hetim E.A (alias T.) që të mos largohet nga banesa e tij, e cila ndodhet në ***;
- Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për ekzekutimin e këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, më 27.07.2026.

Kontakt:

Enida Demiraj

Shef i Sektorit të IT, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë

Email: enida.demiraj@gjykata.gov.al

Tel: +355 69 72 30 447